



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1048/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit MTS shpk me numër regjistrimit të biznesit 71206742, me seli në Mitrovicën e Veriut, e përfaqësuar nga D.O., kundër të paditurës Autoriteti i Konkurrencës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e palës paditëse, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.591/2023 të datës 15.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet ankesa e paditësit/propozuesit MTS shpk me numër regjistrimit të biznesit 71206742 me seli në Mitrovicën e Veriut, Anulohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.591/23 i datës 15.03.2024, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rishqyrtim dhe rivendosje

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në rivendosje, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit MTS shpk me numër regjistrimit të biznesit 71206742, me seli në Mitrovicën e Veriut, e përfaqësuar nga D.O., me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.120/23 datës 18.12.2023 të paditurit Autoriteti i Konkurrencës në Prishtinë, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi/propozuesi MTS shpk me numër regjistrimit të biznesit 71206742, me seli në Mitrovicën e Veriut, e përfaqësuar nga D.O., me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk eliminoi mangësitë e sjella në vëmendje nga gjykata e apelit, lidhur me zotësinë financiare të paditësit për ta paguar gjobën. Gjithashtu aktvendimi kontestues paraqet shkelje të Ligjit për përdorimin gjuhëve, sepse aktvendimi është dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe në kundërshtim me nenin 6 par.1 dhe nenin 96 të LPK-së, prandaj të drejtat themelore procedurale të paditësit janë shkelur në këtë procedurë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit/propozuesit, gjen se gjykata e shkallës së parë, në rivendosje, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr.120/23 datës 18.12.2023 i nxjerr nga i padituri Autoriteti i Konkurrencës në Prishtinë, ka gjetur se pretendimet e paditësit në kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit lidhur me dëmin e pariparueshëm janë të pabazuara, ngase paditësi këto pretendime nuk i ka bazuar në prova për ta vërtetuar qarkullimin e përgjithshëm që ka realizuar në tërë botën në vitin fundit për të cilin është përmbyllur raporti financiar. Gjykata vlerëson se është detyrim i paditësit të paraqes provat për vërtetuar këto pretendime nga neni 319 të LPK-së. Paditësi ka bashkangjitur dëshmitë si pasqyrat mujore të tatimit dhe kontributeve për BI, formularin e deklaratimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhura, ndërsa paditësi nuk ka bashkangjitur raport financiar bankar për të dëshmuar qarkullimin e përgjithshëm në vitin e fundit i cili raport nuk duhet të kufizohet vetëm në qarkullimin vjetor por të dëshmohet me raporte nga të gjitha vendet të cilat operon e që sipas vendimit të kundërshtuar rezulton se paditësi në vitin 2022 në Serbi ka realizuar qarkullim në vlerë prej 983,859.968.64€. Nga raportet bankare të dorëzuara nga paditësi në NLB Bank, gjykata vlerëson se këto raporte nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar qarkullimin vjetor. Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka rrit të dëshmojë me prova se ekzekutimi do sillte dëm paditësit që parashihet me nenin 22 të LKA-së

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i dhomës së shkallës së parë, nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të nenit 182 pika (j) të LPK-së, e që përbëjnë arsye për anulimin e këtij aktvendimi.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhomat e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me aktet administrative kontestuese të paditurës, pretendimet ankimore të ankuesit/propozuesit, erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktvendimi i atakuar ka të meta të dukshme në zbatimin të dispozitës ligjore të lartcekur. Kolegji nga shkresat e lëndës, vlerësoi se vendimi kontestues i gjykatës së shkallës së parë, të cilin e ka pranuar paditësi/propozuesi (fletë kthesa dt.15.03.2024), nuk është në gjuhën zyrtare që e përdor propozuesi, prandaj Kolegji aprovoi pretendimet ankimore se në rastin konkret janë shkelur të drejtat thelbësore nga neni 182 par.2 pika (j) e LPK-së: që parasheh:

*Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet.*

Shkeljet e tilla që bien ndesh me ligjin, përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Dhoma e Shkallës së Parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitohet të gjitha të metat të cekura më lartë, të evitohet të metat ligjore nga neni 96 par.1, 182 par.2 (j) të LPK-së, të respektohen të drejtat ligjore të palës në procedurë, ashtu që ti dorëzohen të gjitha parashtrirat dhe vendimet gjyqësore, në gjuhën e vet që është në përdorim në gjykatë, dhe t,i mundësohet, që të deklarohet në drejtim të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit-shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu në rivendosje, Dhoma e shkallës së parë, të rivlerësojë edhe vërejtjet e cekura në aktvendimin KDHSII.576/24 dt.07.03.24 të Dhomave të shkallës së dytë, përkitazi me vërtetimin e provave se propozuesi posedon fuqi të mjaftueshme financiare për të përmbushur obligimin ndaj të paditurit, nëse ekzekutimi i vendimit të paditurit do të sillte dëm të riparueshëm paditësit, nëse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, gjithnjë duke u bazuar në nenin 22 të LKA-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1048/24 datë 29.05.2024

Kryetari i Kolegjit  
Krenar Berisha